

I nderuar Z. zëvendësministër Alban Zusi,

Të nderuar përfaqësues të universiteteve e institucione shkencore e aplikative nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia,

Të nderuar pjesëmarrës,

Të nderuar organizatorë të këtij simpoziumi,

Është një kënaqësi e veçantë të përshëndes këtë simpozium të rëndësishëm, kushtuar diversitetit biologjik, për ruajtjen, zhvillimin dhe përdorimin e qëndrueshëm e efektiv ekonomik, për të cilin jemi të gjithë të interesuar.

Vlerësoj këtë rast të mirë që në emër të Akademisë së Shkencave, të shpreh nderimin më të madh për të gjithë ata që jetën e tyre profesionale ia kushtojnë studimit të pasurisë mjaft të çmuar të biodiversitetit; të përshëndes dhe të përgëzoj ata që me pasion dhe këmbëngulje punojnë për ta studiuar, ruajtur, zhvilluar dhe përdorur në mënyrën më të mirë të mundshme këtë pasuri të madhe të vendit tonë.

Duke njohur dhe pranuar lidhjen e pazgjidhshme midis diversitetit biologjik dhe atij kulturor, Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë bën thirrje për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ndërveprimit midis tyre në kuadër të qëndrueshmërisë globale; duhet gjithashtu që të forcohen lidhjet midis nismave në kuadër të diversitetit biologjik dhe kulturor, dhe të rritet sinergjia midis dispozitave të ndërlidhura e konventave dhe programeve që kanë të bëjnë me këtë çështje. Vetë këtë vit, në këtë kuadër, në kontinentet e Europës, Amerikës së Veriut, Amerikës Latine, Azisë; Afrikës e deri në Karaibe janë organizuar mjaft aktivitete si konferenca, trajnime dhe workshop-e. Lidhjet e diversitetit biologjik dhe atij kulturor janë të një rëndësie të madhe, mbase dhe jetësore, sepse kanë të bëjnë me traditat e zakonet e një vendi. Fatmirësisht, Shqipëria ka shumë për të thënë për lidhjet midis natyrës dhe kulturës së saj.

Megjithatë, gjatë gjithë historisë sonë, rezultatet e ndërveprimeve të tilla, duke përfshirë ato bujqësore dhe pyjore, praktikat tradicionale, kanë qenë kritike për krijimin e modeleve elastike të peizazhit, për diversifikimin e burimeve biologjike dhe kulturore dhe formësimin e identitetit kulturor të rajoneve të ndryshme vendit.

Cilësia e peizazheve tona, me të cilën është lidhur cilësia e jetës përcaktohet nga bashkëveprimi i ngushtë mes aspekteve ekonomike, sociale dhe kulturore. Ruajtja e tipareve të tilla kontribuon në cilësinë më të lartë të jetës për popullsinë lokale, nëpërmjet gërshetimit të materiales dhe jomaterialës. Këto karakteristika që përmirësojnë jetën e njerëzve, kontribuojnë në ekonominë lokale, ndërsa përmbushin nevojat e tyre krijuese, emocionale dhe shpirtërore. Ruajtja e modeleve komplekse të peizazhit që pasqyrojnë identitetin e rajoneve të ndryshme dhe praktikat e tyre të menaxhimit, duhet të sigurohen përmes strategjive të integruara të planifikimit dhe menaxhimit.

Është gjithashtu e rëndësishme që të zhvillojmë strategji të integruara, ku mund të angazhohet dhe publiku i gjerë dhe pushteti lokal për të përmirësuar, ruajtur dhe mirëmbajtur lidhjet midis diversitetit kulturor dhe biologjik, duke kontribuar kështu në mirëqenien e popullatës së gjerë. Më shumë hulumtime mbi lidhjet midis diversitetit kulturor dhe biologjik në cilësinë peizazhit, janë gjithashtu të nevojshme. Jo rrallëherë njohuritë rreth tyre ose janë injoruar ose kanë humbur me kohë, duke konstatuar ndarje ndërmjet natyrës dhe kulturës për sa i përket politikave, por edhe mes shkencave të natyrës dhe atyre humane në studimin dhe menaxhimin e vlerave natyrore dhe kulturore, gjë që ndikon në ruajtjen e trashëgimisë kulturore e asaj natyrore.

Biodiversiteti është një burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik e shoqëror; fatkeqësisht, ai mund të keqpërdoret deri në shterim. Nevojat për prodhim, për të plotësuar nevojat ushqimore dhe të jetës, kërkojnë të përdoren gjithnjë e më shumë potencialet e botës së gjallë, bimore e shtazore. Përdorimi racional i këtyre potencialeve është domosdoshmëri. Është detyra jonë të gjejmë rrugët më të mira e

më të sigurta, për ta mbrojtur këtë pasuri, për ta përdorur dhe për ta zhvilluar më tej; pra, është detyrë e kontributit sa më racional të kërkimit shkencor e të praktikave prodhuese inovative në këtë drejtim. Bashkimi Europian në Programin Horizon-2020 ka vendosur përparësi sigurinë ushqimore krahas shëndetit dhe sigurisë së energjisë. Po kështu, edhe në plotësim të detyrave të realizimit të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacionit një nga programet përparësore është Bujqësia dhe Ushqimi.

Ndaj dhe simpoziumi i sotëm duhet të jetë një ndër produktet e përpjekjeve tona të përbashkëta për të realizuar përparësitë e biodiversitetit: të ruajtjes e përdorimit të qëndrueshëm për zhvillimin rural. Tashmë këtë aktivitet kaq të rëndësishëm e kemi bërë traditë; edhe ky simpozium, me këto prurje tepër intriguese prej 26 kumtimesh dhe 53 posterash, është një mundësi më shumë për të reflektuar mbi arritjet dhe për të diskutuar për çka që duhet të bëjmë, për të përballuar sfidën për ruajtjen, miradministrimin dhe zhvillimin e biodiversitetit në vendin e rajonin tonë.

Sfida që kemi përpara është e madhe; ajo është sfidë globale. Ndaj dhe përballja e saj mund të arrihet vetëm kur të gjithë të jemi të ndërgjegjshëm e bashkë në kërkim e zhvillim.

Në emër të Seksionit të shkencave natyrore dhe teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ju uroj suksese në debatet shkencore frutdhënëse e në përcaktimin e detyrave për të ardhmen!

Faleminderit